



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SUHAREKËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, maj 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Suharekës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës (KS), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Suharekës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Keqklasifikim i shpenzimeve në kategoritë e ndryshme ekonomike në vlerë 2,507,110€.
- A1 Nënvlërësim i obligimeve të papaguara për 42,118€.
- A2 Detyrimet kontingjente të prezantuara në nenin 18 në Raportin Vjetor Financiar ishin të mbivlerësuara për 19,786€.
- B2 Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme për 10,685€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Suharekës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A3 Në 15 pagesa në vlerë totale prej 305,213€, janë bërë ndryshime në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal.
- A4 Zyra e prokurimit në dy raste kishte specifikuar emrin e prodhuesit në paramasën dhe parallogarinë.
- A5 Në kontratën me çmime për njësi, vlera e shpenzuar e një kategorie të caktuar, ka tejkaluar vlerën e lejuar për shpenzim sipas peshimit.
- A6 Përdorimi i gabuar i kontratës publike kornizë.
- B3 Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës.
- B4 Dhënia e subvencioneve jo në përputhje me thirrjen publike.
- B5 Mungesa e projekteve ekzekutuese.
- B6 Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë.
- A7 Mungesë e raporteve për vijueshmërinë në punë.
- A8 Komuna nuk kishte arritur që të bëjë verifikimin e 20% të pronave të tatueshme.
- A9 Në pesë (5) raste në vlerë prej 45,453€, pasuria jo kapitale nën 1,000€, nuk ishte regjistruar në sistemin e e-pasurisë.
- B7 Vonesa në pagesën e obligimeve ndaj kontraktuesve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Suharekës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Suharekës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Suharekës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Suharekës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, goftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Suharekës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: keqklasifikim e shpenzimeve, ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal, mosrespektim të hapave gjatë procedimit të pagesave, mangësi në prokurim, mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme dhe detyrimeve kontingjente, vlerësimi i aplikacioneve të fermerëve në kundërshtim me thirrjen publike, vonesa në pagesën e faturave, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm. Ky raport ka rezultuar me 19 rekomandime, prej tyre 10 janë rekomandime të reja, dhe 9 të përsëritura.

Vlen të theksohet se gjatë vitit 2024, ishin realizuar pagesa nga Thesari, në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore në vlerë 4,133,857€, nga kjo vlerë për kontratën kolektive ishin paguar 4,107,583€, pjesa tjetër për shpronësim (3,330€), dhe (22,944€) për operator ekonomik. Sipas regjistrimit të komunës borxhi kryesor ishte 3,110,269€, ndërsa 1,023,588€, ishin shpenzime të interesit dhe shpenzime tjera procedurale të gjykatës/përmbartimit.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Keqklasifikim i shpenzimeve

Gjetja

Neni 18, paragrafi 3 i Rregullës Financiare nr.01/2013/MF për Shpenzimin e Parasë Publike, parasheh se “shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Në planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet t'i aplikojnë.

Sipas shënimeve të ofruara nga komuna ishin bërë keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë prej 2,507,110€. Nga kjo vlerë thesari kishte paguar sipas vendimit përmbartimor/ të gjykatës për paga jubilarë, shujta dhe kualifikim për arsimtar nga kategori investimet kapitale 1,620,470€, mallra dhe shërbime dhe komunalit 727,927€, dhe nga subvencione dhe transfere 109,044€. Po ashtu nga kategoria mallra dhe shërbime komuna kishte paguar 49,669€, që për nga natyra i takojnë kategorisë investime kapitale.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së ndarjeve buxhetore në kategorinë ekonomike adekuate për t'i realizuar pagesat e vendimeve gjyqësore/përmbartimore si dhe buxhetimit dhe planifikimit jo të mirë buxhetor.

Ndikimi

Pagesat e bëra nga kategoria jo-adekuate, shpien në paraqitjen e shënimeve të gabuara në Pasqyrat Financiare të komunës, ku të dhënat

për kategori të shpenzimeve nuk janë të sakta dhe si të tilla japin informata çorientuese për shfrytëzuesit e PFV-e.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridentinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A1 - Nënvlërësim i obligimeve të papaguara

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Raporti i detyrimeve të papaguara (1,666,133€), i prezantuar në nenin 17 të RVF-së është i nënvlerësuar për 42,118€, sepse fatura në vlerë 87,118€, ishte paguar 45,000€, përderisa pjesa e papaguar e mbetur nuk ishte raportuar si obligim.

Kjo ka ndodh si rezultat i kontrolleve jo të mira tek zyra e financave për t'i raportuar obligimet komunale si duhet.

Ndikimi Mosprezantimi i të gjitha obligimeve të papaguara në RVF ndikon që palët e interesit a po shfrytëzuesit e RVF-së të marrin informata të pasakta për obligimet e papaguara.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se zyra e financave do t'i prezantoj të gjitha obligimet e papaguara në RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mbivlerësim i detyrimeve kontingjente

Gjetja Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: “Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare”.

Detyrimet kontingjente në vlerë 5,734,158€ të prezantuara në nenin 18 në Raportin Vjetor Financiar (RVF) ishin të mbivlerësuara për 19,786€, për faktin se padia në vlerë 81,620€, është prezantuar gabimisht në vend se të prezantohej vlere 61,834€.

Paraqitja e detyrimeve kontingjente në vlere jo të sakta ka rrjedhur si rezultat i mungesës së vëmendjes nga zyrtari i cili mbanë evidencat lidhur me detyrimet kontingjente si dhe nga pamjaftueshmëria e kontrollit të brendshëm nga zyrtari kryesor financiar për t'i verifikuar vlerat gjatë prezantimit të detyrimeve kontingjente në RVF.

Ndikimi Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlere jo të sakta ndikon që palët e

interesit apo shfrytëzuesit e RVF-së të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën detyrimeve kontingjente.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e përgatitjes së RVF, detyrimet kontingjente do të vlerësohen dhe paraqiten me vlera të sakta.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Neni 10. Paragrafi 1.1 i Ligjit nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, përcakton se “Tatimi në pronën e paluajtshme nuk do të vendoset në pronën e paluajtshme e cila është në pronësi të institucioneve të Republikës së Kosovës”.

Nga testet tona për llogaritë e arkëtueshme, në një rast në vlerë 10,685€ kemi vërejtur se komuna kishte ngarkuar me tatim pronën/parcelën e cila ishte në pronësi publike, ku rrjedhimisht llogaritë e arkëtueshme të raportuara në RVF ishin mbivlerësuar për këtë vlerë. Duhet theksuar se gjatë fazës së ekzekutimit të auditimit në vitin 2025, komuna ka ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe ka korrigjuar këtë çështje.

Mungesa e një rishikimi adekuat nga ana e komunës për aplikimin e ngarkesës komunale për tatimin mbi pronën e paluajtshme ka bërë që llogaritë e arkëtueshme të jenë të mbivlerësuara.

Ndikimi Aplikimi i ngarkesës tatimore për pronën e paluajtshme e cila është në pronësi publike ka ndikuar direkt në mbivlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme gjatë faturimit të tatimit në pronë dhe në rastet kur tatimi në pronë i ngarkohet pronave të cilat janë të liruara me ligj të ndërmarrë veprimet e nevojshme për korrigjim dhe reflektim në RVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore të projekteve kapitale pa aprovim të Kuvendit Komunal

Gjetja

Neni 16 paragrafi 11 i Ligjit nr. 08/I-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 parasheh se “Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2, duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal”.

Në 15 pagesa* të investimeve kapitale, në vlerë totale prej 305,213€, fondet ishin marrë nga projekte tjera të aprovuara në ligjin e buxhetit. Fondet janë paguar pasi që ato janë lejuar me aktvendime nga Kryetari i Komunës për bartje nga një projekt në projektin tjetër sipas kërkesës së drejtorisë përkatëse. Megjithatë, për këto ndryshime në shumat e ndara buxhetore për projekte, nuk ishte kërkuar me u marrë aprovimet nga Kuvendi Komunal.

Kjo kishte ndodhur për shkak se Ministria e Financave me vendime përmbarimore i kishte paguar nga projektet kapitale obligimet e dala nga kontrata kolektive në arsim për shujta, kualifikime, transport.

Ndikimi

Ndryshimet në shumat buxhetore pa aprovim të Kuvendit Komunal, mund të reduktojnë transparencën dhe llogaridhënien në vendimet e marra rreth shfrytëzimit të fondeve publike. Këto, po ashtu mund të kenë ndikim negativ në implementimin e projekteve ekzistuese duke pamundësuar financimin e mjaftueshëm për to.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë, se për çdo ndryshim në shumat buxhetore të projekteve të aprovuara në ligjin e buxhetit, të marrë paraprakisht aprovimin nga Kuvendi Komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Specifikimi i prodhuesit në paramasën dhe parallogarinë

Gjetja

Neni 17 paragrafi 2 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se "Asnjë specifikim nuk do të lëshohet me referencë ndaj një marke të caktuar tregtare, emër të brendit, patentë, dizajn, lloj, origjinë specifike, prodhues, montues, katalog ose artikull me numër. Kur nuk ka mënyrë tjetër precize ose të përshtatshme për karakterizimin e kërkesave përveç referencës, përshkrimi do të përdorët, pasuar nga fjalët “ose të barasvlershme”.

Zyra e prokurimit në paramasën dhe parallogarinë e projekteve “Ndërtimi i sallave sportive në ShFMU Naum Veqilharxhi- Muhlan” në vlerë 279,999€, dhe “Ndërtimi i sallave sportive në ShFMU Shaban Mazreku- Sopijë” në vlerë 268,480€, kishte përmend emrin e prodhuesit në disa pozicione si: Pozicioni 13 Punët e zdrukthëtarisë respektivisht nënpozicionet 13.7, 13.8, 13.11, 13.12, 13.13 që ka të bëjë me furnizimin dhe montimin e dyerve

është përdor emri i prodhuesit Horman apo i ngjashëm.

Po ashtu te pozicioni 4 Instalimet makinerike respektivisht në pozicioni 4.6 që ka të bëjë me furnizim dhe montim të radiatorëve është përdor emri i prodhuesit Kosova Term ose të ngjashme Gjilanit.

Kjo ka ndodh për shkak të mungesës së kontrolleve të zyrës së prokurimit për ta parandaluar specifikimin e emrit të prodhuesit në paramasën dhe parallogarinë.

Ndikimi Specifikimi i emrit të prodhuesit në paramasën dhe parallogarinë mund të ndikoj në dëmtimin e konkurrencës dhe trajtimit jo të barabartë të operatorëve ekonomik.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit nuk do ta lëshoj dosjen e tenderit nëse në paramasën dhe parallogarinë specifikohet emri i prodhuesit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A5 - Realizimi i sasive të kontratës me çmim për njësi, në mos përputhje me peshën e përcaktuara në dosje të tenderit

Gjetja Neni 17 dosja tenderit paragrafi 35 i Bazuar në Rregulloren nr.001/2022 për prokurimin publik, parasheh se "Kurdo që Autoriteti Kontraktues (AK) nuk din sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës kategori të shërbimeve në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në baze të poentimit. Si rrjedhojë, peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit. Menaxheri i kontratës mbetet përgjegjës që të dëshmoj në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të AK".

Kontrata publike kornizë me çmim njësi "Hartimi dhe revidimi i projekteve" me vlerë të parashikuar 85,900€, kategoria E "hartimi i projekteve ideore dhe kryesore të veprave të artit" ishte peshuar me 5% e kur kjo shprehet me vlerë i bie të jetë 4,295€. Kjo kategori ishte realizuar 57,884€, pra me një tejkalim prej 53,589€. Vlen të theksohet se kontrata në total nuk është tejkaluar.

Tejkalimi ka ndodhur si rezultat i mbikëqyrjes së dobët nga ana e menaxherit të projektit.

Ndikimi Tejkalimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës që iu është caktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë, ndikon në mungesë të transparencës në vendimmarrjen për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët. Kjo poashtu, mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve të planifikuara buxhetore dhe mosrealizimin e kategorive tjera të peshuara sipas kontratës.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se menaxhimi i kontratës nga menaxheri i projektit bëhet në pajtim me kërkesat ligjore, në mënyrë që kontrata publike

kornizë me çmim njësi të realizohet në pajtueshmëri të plotë me peshën e përcaktuar në dosjen e tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A6 - Përdorimi i gabuar i kontratës publike kornizë

Gjetja

Neni 54-Kontratat Kornizë respektivisht paragrafi 54.2 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se "Kontrata publike kornizë është term i përgjithshëm i marrëveshjeve në mes të autoriteteve kontraktuese si dhe operatorëve ekonomik për furnizime, shërbime, dhe punë (riparim/ mirëmbajtje), e cila i vendos termat dhe kushtet sipas të cilave kontratat ndihmëse ose bërja e urdhrave mund të kryhet përmes termave të marrëveshjes. Po ashtu paragrafi 54.15 ndër të tjera parasheh se" Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dine sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në baze të rëndësisë se secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Kontratat me çmime për njësi mund të udhëhiqen për të gjitha llojet e kontratave, kontratë për furnizime, shërbime dhe punë (riparime dhe mirëmbajtje).

Zyra e prokurimit gabimisht kishte përdorur llojin e kontratës publike kornizë çmim njësi për punë për projektin kapital "Ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugëve lokale në qytete dhe fshatra" me çmim për njësi 345€, dhe vlerë të parashikuar prej 600,000€. Kontrata nuk do të duhej të ishte publike kornizë me çmim njësi por kontratë për punë me çmim fiks, pasi që kontratat publike kornizë për punë sipas rregullores lejohet vetëm në rastet kur kemi të bëjë me kryerjen e punëve për riparim/mirëmbajtje por jo edhe për ndërtimin e rrugëve.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve nga zyra e prokurimit për t'i respektuar kërkesat ligjore që ndërlidhen me kontratën publike kornizë për punë.

Ndikimi

Përdorimi i gabuar i llojit të kontratës publike kornizë me çmim për njësi për punë për ndërtimin e rrugëve, mund të shkaktoj probleme gjatë realizimit të projektit për shkak se sasi të në pozicionet e paramasës dhe prallogarisë nuk janë përcaktuar si duhet. Ato në secilin pozicion janë me sasinë 1.

Rekomandimi A6

Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në mënyrë që zyra e prokurimit zbaton kontratën e duhur ashtu siç e parasheh rregullativa ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B3 - Mosrespektim i hapave për procedimin e pagesave sipas kërkesës së Rregullës

Gjetja

Neni 22 i Rregullës Financiare Nr.01/2013/MF - Shpenzimi i parave publike, përcakton hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht bëhet Kërkesa për blerje, lëshohet urdhërblerja, bëhet pranimi i mallit, pastaj Operatori Ekonomik sjellë faturën për pagesë.

Nga 59 mostrat e testuar si pjesë e testimave substanciale në investime kapitale kemi vërejt se në 23 raste në vlerë 1,173,776€, nuk janë respektuar hapat për procedimin e pagesave, ku fillimisht është bërë pranimi i faturës dhe situacioni për punët e kryera e pastaj është lëshuar urdhërblerja.

Kjo ishte si pasojë e dështimit të kontrolleve nga zyra e prokurimit pasi që zyra e prokurimit nuk i kishte respektuar hapat për procedim të pagesave sipas rregullës financiare.

Ndikimi Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave mund të shkakton rritjen e obligimeve komunale ndaj operatorëve ekonomik.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se zyra e prokurimit do t'i ndjek të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuar me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike për subvencionimin e fermerëve me serra në bujqësi

Gjetja Bazuar në thirrjen për aplikim nr. 08-15 të datës 26.02.2024 nga Drejtoria e Bujqësisë për subvencionimin e ndërtimit të serave në Komunën e Suharekës, ndër kriteret e kërkuara për aplikim ishte edhe kërkesa që aplikantët duhej të posedojë tokë bujqësore së paku 0.5ha.

Ne kemi vërejtur se pesë (5) përfitues të serave nuk kishin ofruar dëshmi që tregon se kanë në posedim së paku 0.5ha tokë bujqësore.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mospërgjegjshmërisë së komisionit të vlerësimit i cili kishte vendosur për aprovimin e kërkesës jo në përputhje me kriteret e thirrjes.

Ndikimi Subvencionimi jo në përputhje me thirrjen publike, ndikon negativisht tek aplikuesit tjerë mbi transparencën e procesit të ndarjes së subvencioneve.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të përmirësojë procesin e vlerësimit për dhënien e subvencioneve, duke siguruar që vetëm aplikantët që plotësojnë kriteret të përfitojnë nga subvencionimi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B5 - Mungesa e projekteve ekzekutuese

Gjetja Neni 19 specifikimet teknike paragrafi 17 i Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik ndër tjerash parasheh se "Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet t'i bashkëngjitet (gjithashtu në pajisje elektronike) Specifikave Teknike, të cilat janë pjesë të dosjes së tenderit. Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohet që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkëngjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit".

Nga testimi jonë ka rezultuar se për tri (3) projekte kapitale nuk ishte përgatitur projekti ekzekutiv. Rastet kanë të bëjë me projektet:

Projekti “Ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugëve lokale në qytete dhe fshatra” në vlerë 600,000€.

Projekti “Ndërtimi dhe sanimi i kanalizimeve në Suharekë dhe fshatrat Samadraxhë, Bllacë, Sllapuzhan, Peqan, Semetisht, Reshtan Studençan dhe Kastërc” Lot 2 në vlerë 223,550€.

Projekti “Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatin Bukosh” në vlerë 28,147€.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrollit nga zyra e prokurimit pasi që ka kryer aktivitetin e prokurimit në mungesë të projektit ekzekutiv për projektet specifike.

Ndikimi Mungesa e projektit ekzekutues mund të shkaktoj vështirësi në realizimin e projekteve gjatë fazës së ekzekutimit, dhe rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin profesional, ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve dhe monitoroj zbatimin e kërkesave ligjore, që me rastin e inicimit të procedurave të prokurimit për kontraktimin e punëve të sigurohet paraprakisht hartimi i projekteve ekzekutive në përputhje me nevojat dhe kërkesat e parashikuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Mangësi në bazën e të dhënave të tatimpaguesve në pronë

Gjetja Ligji Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, Neni 12, thekson se komuna ka përgjegjësi për regjistrim dhe menaxhim të të dhënave të tatimit në pronë në regjistrat e tatimit në pronë ashtu siç përcaktohet në aktin nënligjor.

Përveç kësaj, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë, ka njoftuar komunat për vendimin e marrë për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, me qëllim të shmangies së dyfishimeve/apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.

Gjatë analizës së bazës së të dhënave të tatimit në pronë është identifikuar se 1,309 tatimpagues individual nuk kanë të prezantuar numrat personal në këtë bazë.

Kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mos verifikimit të pronave në fjalë dhe mos azhurnimit të shënimeve në sistemin e tatimit në pronë nga njësia komunale e tatimit në pronë.

Ndikimi Mungesa e të dhënave në data bazë për numrat identifikues personal të tatimpaguesve paraqet mangësi dhe potencialisht mund të ndikojë në përfitim të paligjshëm të disa hershëm të tatimpaguesve, të zbritjes së

lejuar për vendbanim parësor.

Rekomandimi B6 Kryetari duhet të ndërmerr veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Mungesë e raporteve për vijueshmërinë në punë

Gjetja Neni 17 i Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 evidenca e vijueshmërisë në punë, ndër të tjera parasheh “Zyrtari publik është i obliguar që të regjistrohet në regjistrin elektronik të vijueshmërisë. Vijueshmëria në punë e zyrtarit publik evidentohet përmes regjistrimit në sistemin elektronik që administrohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Kur nuk është e mundur për arsye teknike, vijueshmëria në punë e zyrtarit publik bëhet përmes regjistrimit në librat evidentues”. Mungesa e evidentimit të vijueshmërisë në punë nga zyrtari llogaritet si mungesë në punë.

Gjatë testimit të 40 mostrave për kategorinë paga dhe mëditje, kemi identifikuar se për katër (4) zyrtarë komunal nuk kishte evidenca të vijueshmërisë së rregullt në punë, prej të cilëve për një (1) zyrtar nuk kishte evidencë për periudhë 12 mujore ndërsa për tre (3) zyrtarët tjerë nuk kishte evidencë për periudhë që varionte nga 4 deri në 6 muaj.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i dështimit të zyrtarëve për tu evidentuar në regjistrin elektronik të vijueshmërisë në punë si dhe mungesës së kontrollit të brendshëm për të mbikëqyrur evidencën në punë të zyrtarëve.

Ndikimi Mungesa e raporteve të vijueshmërisë në punë paraqet parregullsi, krijon paqartësi dhe pasiguri nëse zyrtarët komunal kanë pasur vijueshmëri të rregullt në punë si dhe nëse është arsyetuar me punë pagesa e tyre.

Rekomandimi A7 Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët komunal të evidentohen rregullisht në regjistrin e vijueshmërisë për punë dhe kjo të dëshmohet përmes raporteve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Mangësi në inspektimin e objekteve komunale

Gjetja Neni 15 i Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, paragrafi 2 parasheh “Veprimtaritë inspektuese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës dhe vetëm kur është e nevojshme për parcelat”. Poashtu paragrafi 1 i këtij neni parasheh “Komuna inspekton pronat e paluajtshme brenda territorit të Komunës. Komuna mund të angazhojë inspektor privat për të ndihmuar në veprimtaritë inspektuese”.

Komuna gjatë vitit 2024 nuk kishte arritur të përmbushë kuotën ligjore 20% për inspektim të objekteve. Përkundër planifikimit që gjatë vitit të inspektohen 3,555 objekte nga gjithsejtë 17,777, anketuesit kishin arritur të inspektonin 1,868 apo vetëm 10.50%.

Sipas konfirmimit të zyrtarit përgjegjës të tatimit në pronë, përkundër përpjekjeve, kjo ka ndodhur si rrjedhojë e mungesës së stafit të mjaftueshëm për kryerjen e inspektimeve, sfidave në teren për të marr informatat e pronarëve të objekteve, me raste edhe mungesa e rrjetit të internetit në teren dhe tjera.

Ndikimi Mos arritja e inspektimit të 20% të objekteve mund të rezultojë në ngarkesë të mbivlerësuar apo nënvlerësuar tatimore për tatimpaguesit.

Rekomandimi A8 Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A9 - Mosregjistrimi i pasurive jo kapitale në sistemin e e-pasurisë

Gjetja Rregullorja MF-NR. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 6.3. përcakton se, "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Nga testimi jonë ka rezultuar se në pesë (5) raste në vlerë prej 45,453€, pasuria jo kapitale nën 1,000€, nga drejtoria e arsimit nuk ishin regjistruar në sistemin e e-pasurisë.

Mos regjistrimi i pasurisë jo kapitale në sistemin e e-pasurisë ka ndodhur për shkak se zyrtarja e pasurisë që bënë regjistrimin e pasurisë jo kapitale për drejtorin e arsimit kishte qenë në pushim të lehonisë.

Ndikimi Mosregjistrimi i të gjitha pasurive jokapitale nën 1,000€, në regjistrin e e-pasurisë ndikon në raportim të pasaktë të pasurive jokapitale në pasqyrat financiare.

Rekomandimi A9 Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar regjistrimin e pasurisë nën 1,000€, në regjistrat kontabël të e-pasurive.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Vonesa në pagesën e obligimeve

Gjetja Neni 39.1 i Ligjit të Menaxhimit të Financave Publike dhe Përgjegjësit parasheh se "ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore".

Në katër (4) raste në vlerë 135,642€, kemi vërejtur se komuna nuk i kishte kryer obligimet financiare brenda afatit prej 30 ditësh. Këto fatura të pranuar në vitin 2024, nuk ishin paguar deri sa ne ishim në auditim (shkurt) 2025.

Kjo ka ndodhur për shkak se komuna nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare dhe ka hyrë në obligime pa bërë ndonjë analizë të mirëfilltë buxhetore.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e obligimeve mund t'i shkaktojnë kosto shtesë komunës për shkak se ajo mund të përballet me padi ku përveç vlerës së faturës duhet t'i paguaj kostot shtesë përfshirë kamatën, interesin dhe shpenzimet gjyqësore.

Rekomandimi B7

Kryetari duhet të siguroj se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, si dhe obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimi të faturave në mënyrë që të shmangen pagesat shtesë të interesit nga vendimet gjyqësore/përmbarimore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2024, ishin 2,252,469€, përderisa ishin realizuar 2,450,094€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2024, ka pranuar të hyra nga gjrobat nga trafiku, gjrobat e gjykatës dhe të hyrat nga agjencioni i pyjeve në vlerë totale prej 504,248€.

Çështja B8 - Mangësi në raportimin e rregullt për shfrytëzim të pronave komunale

Gjetja Neni 22 paragrafi 2 i Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, përcakton se “Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore t’i paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim”.

Komuna kishte përgatitur raporte të rregullta gjashtë (6) mujore, mirëpo këto raporte nuk përmbanin informata lidhur me monitorimin e realizimit të kontratave që kanë të bëjnë me dhënien në shfrytëzim të pronave komunale. Edhe në vitin 2024, komuna kishte lidhur katër (4) kontrata të reja për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme komunale si dhe kishte ripërtërirë tri (3) kontrata tjera, por nuk kishte raportuar për qëllimin e dhënies në shfrytëzim dhe mbikëqyrjes së tyre.

Shkak i ndodhjes është mungesa e kontrollit të brendshëm në lidhje me raportimin dhe mbikëqyrjen e kontratave për shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.

Ndikimi Mungesa e raportimit për monitorimin e kontratave për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim përveç se krijon pa pajtueshmëri ligjore dhe ndikon në realizimin e plotë të të hyrave.

Rekomandimi B8 Kryetari duhet të sigurojë se raportet rregullta gjashtë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 7,850,524€, prej tyre në 2024 ishin shpenzuar 7,693,387€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e rrugëve lokale, ndërtimin e kanalizimeve, ndërtimin e objekteve arsimore dhe shëndetësore, rregullimin e parqeve.

Çështja B9 - Vonesa në realizimin e projekteve

Gjetja

Rregullorja nr.001/2022 për prokurim publik përgjegjësitë e menaxherit të projektit/kontratës paragrafi 70.23 pika b parasheh se " Menaxheri i kontratës sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë". Po ashtu secila kontratë e ka të përcaktuar afatin kohor të implementimit.

Ne kemi vërejtur se komuna në tri raste, nuk i kishte realizuar punimet sipas planit dinamik të paraparë me kontratë, si vijim

- Projekti "Ndërtimi dhe rregullimi i kolektorit në rrugën Skënderbeu" kontrata e nënshkruar me 21.07.2023, në vlerë 929,426€, me afat implementimi për 52 ditë kalendarike. Ky projekt deri në fund të vitit 2024, ishte ende i papërfunduar;
- Projekti "Ndërtimi i sheshit Brigada 123-vazhdim" kontrata e nënshkruar me 13.11.2023, në vlerë 1,388,907€, me afat implementimi për 160 ditë kalendarike. Ky projekt deri në fund të vitit 2024, ishte ende i papërfunduar; dhe
- Projekti " Ndërtimi i parqeve me kënde të lojërave në fshatrat: Duhël, Bllacë, Vraniq dhe Mushtisht" kontrata e nënshkruar me 08.07.2024, në vlerë 86,356.95€, me afat implementimi për 90 ditë kalendarike. Ky projekt deri në fund të vitit 2024, ishte ende i papërfunduar.

Kjo ka ndodhur si rezultat i dështimit të kontrolleve tek menaxherët e projekteve për ta përcjellë implementimin e kontratave në pajtim me planin e paraparë në kontratë.

Ndikimi

Mos realizimi i projekteve sipas kushteve të kontratës ka ndikuar që komuna të mos arrijë objektivat e përcaktuara, si dhe mund të shkaktojë vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

Rekomandimi B9

Kryetari duhet të sigurojë mekanizma adekuat në forcimin e kontrolleve në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që ato të përfundohen me kohë sipas planit dinamik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna e Suharekës në RFV e vitit 2024 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë totale prej 8,102,263€. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë në vlerë 4,894,183€, taksat në biznes për ushtrim të veprimtarisë të pa arkëtuara në vlerë 2,570,177€, të arkëtueshmet nga renta për shfrytëzim të hapësirës publike në vlerë 256,327€ si dhe të arkëtueshmet nga qiraja në vlerë 381,575€. Në krahasim me vitin paraprak, LI/A në vitin 2024 janë rritur për 464,708€ apo 6.08%.

Çështja A10 - Mungesë e veprimeve të mjaftueshme për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Neni 26 i Ligjit Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, përcakton se “Komuna, Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore të papaguara që kalojnë shumën e dhjetë (10) Eurove”.

Ligji Nr. 08/L-244 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr.06/L-055 për tatimin në pronën e paluajtshme, neni 6 specifikon se për vitin tatimor 2024 dhe vitet tatimore pasuese, detyrimi tatimor për personat jo-rezidentë mund të paguhet në një kësht të vetëm, më së largu në datën 30 shtator të vitit tatimor përkatës.

Rregullorja për taksa, tarifa dhe gjoba komunale në Komunën e Suharekës, neni 5 specifikon se të gjitha pagesat e taksave komunale bëhen sipas shumave të përcaktuara në këtë rregullore, ndërsa në faturim janë specifikuar afatet kohore për arkëtim.

Gjatë testimit të mostrave për llogaritë e arkëtueshme, kemi identifikuar se në nëntë (9) raste të papaguara për tatimin në pronë në vlerë 23,848€, si dhe tetë (8) raste të papaguara në vlerë 76,074€ për taksën në biznes për ushtrim të veprimtarisë, komuna nuk ka ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe të mjaftueshme për inkasim të llogarive të arkëtueshme, përkundër faktit se këto llogari janë bartur ndër vite. Duhet theksuar se, LI/A si total për taksën/tatimin e lartcekur janë prezantuar në vlerë 7,464,360€ apo pjesëmarrja e tyre në totalin e LI/A të prezantuara në RFV 2024 është 92%.

Rritja e llogarive të arkëtueshme është si rrjedhojë e mungesës së kontrolleve të brendshme të mjaftueshme, mungesës së veprimeve të nevojshme dhe mjaftueshme në drejtim të inkasimit të LI/A, poashtu mungesës së strategjisë për inkasim.

Ndikimi

Mos realizimi i të hyrave të planifikuara, rritë rrezikun e dështimit të projekteve të planifikuara nga burimet vetanake. Vjetërsia e të arkëtueshmeve e vështirëson apo edhe pamundëson mbledhjen e tyre.

Rekomandimi A10

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e të arkëtueshmeve, si dhe rritjen e efikasitetit për arkëtimin e tyre. Poashtu të analizohen shkaktarët e rritjes së të arkëtueshmeve si dhe të krijojë strategji të mbledhjes së tyre, përfshirë dhe ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore për inkasim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Ne kemi marrë parasysh burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të ardhurave të mbledhura nga kategoritë ekonomike. Kjo është theksuar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ^e	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	22,084,868	25,425,215	25,077,790	21,129,662	18,020,858
Grante Qeveritare - Buxheti	19,832,399	20,918,381	20,823,286	18,726,949	15,517,044
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	107,682
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,647,498	1,630,152	631,930	494,061
Të hyrat vetanake	2,252,469	2,252,469	2,166,578	1,386,174	1,750,633
Donacionet vendore	0	1,656	0	0	4,540
Donacionet e jashtme	0	605,211	457,774	384,609	146,898

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 3,340,347€. Kjo rritje ishte nga granditë e Qeverisë prej 1,085,982€, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak prej 1,647,498€, si dhe donacioneve prej 606,867€.

Komuna ka shpenzuar rreth 99% të buxhetit final e cila paraqet një performancë të mirë buxhetore.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	22,084,868	25,425,215	25,077,790	21,129,662	18,020,858
Pagat dhe mëditjet	11,342,580	12,599,430	12,598,863	10,612,785	9,303,713
Mallrat dhe shërbimet	3,178,428	3,257,145	3,145,973	3,019,067	2,470,247
Komunalitë	586,630	735,519	657,205	339,610	382,760
Subvencionet dhe transferet	955,000	982,597	982,362	899,574	676,958
Investimet Kapitale	6,022,230	7,850,524	7,693,387	6,258,627	5,187,180

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:
Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 1,256,850€, krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës në vlerë 1,206,850€, si dhe rritje prej 50,000€, nga të hyrat vetjake të bartura.


Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 78,717€. Kjo rritje vjen si rritje nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023, për 76,561€, si dhe rritje nga donacionet për 2,156€. Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për furnizime, pasje të teknologjisë informative, mirëmbajtje dhe servisim, pastrim të objekteve. Thesari nga kjo kategori sipas vendimeve përmbarimore/gjyqësore kishte paguar 432,199€, për shujta, kualifikim në arsim obligime të dala nga kontrata kolektive.

Buxheti final për komunalitet është rritur për 148,889€, nga të hyrat vetjake të pashpenzuara nga viti 2023. Nga kjo kategori thesari sipas vendimeve përmbarimore/gjyqësore kishte paguar 295,728€, për shujta, kualifikim në arsim obligime të dala nga kontrata kolektiv.

Buxheti final për subvencione ishte rritur për 27,597€, nga të hyrat vetjake të pashpenzuara nga viti 2023. Shpenzimet kanë të bëjë me pagesat e bëra për përkrahjen e OJQ-ve, të individve si dhe me shpenzimet e bëra nga thesari sipas vendimeve përmbarimore/gjyqësore për shujta, kualifikim në arsim në vlerë prej 109,044€.

Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,828,294€. Kjo rritje vjen si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake të pa shpenzuar nga vitin 2023 për 1,344,451€, rritje nga donacionet për 604,711€, dhe zvogëlim i kategorisë së investimeve kapital prej 120,868€, me vendim të Qeverisë. Shpenzimi nga kjo kategori ndër tjerash kanë të bëjë me pagesat e bëra për projektet kapitale si për ndërtimin e rrugëve lokale, rregullimin e ujësjellsit dhe kanalizimeve, ndërtimin e objekteve, fushave sportive. Vlen të ceket se thesari nga kjo kategori sipas vendimeve përmbarimore/gjyqësore kishte paguar 1,620,470€, për shujta, kualifikim në arsim obligime të dala nga kontrata kolektive.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2024, ishin 2,252,469€, përderisa ishin realizuar 2,450,094€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2024, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku, gjobat e gjykatës dhe të hyrat nga agjencioni i pyjeve në vlerë totale prej 504,248€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministrinë e linjës. Nga tabela më poshtë shihet se të hyrat tatimore nga tatimi në pronë dhe paluajtshmëri janë realizuar vetëm 53.18% dhe kjo si rezultat se komuna nuk ka arritur të realizoj planin e të hyrave. Rrjedhimisht janë rritur edhe llogaritë e arkëtueshme për këtë kategori.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	2,252,469	2,252,469	2,450,094	2,397,438	1,834,297
Të hyrat tatimore	1,323,396	1,323,396	544,389	1,023,369	884,224
Të hyrat jo tatimore	929,073	929,073	1,905,705	1,374,069	950,073

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023, kishte rezultuar me 10 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2023 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Deri në fund të auditimit tonë, një (1) rekomandim ishte zbatuar, dhe nëntë (9) rekomandime nuk ishin zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të përmirësojë procesin e vlerësimit për dhënie të subvencioneve, duke siguruar që vetëm aplikantët që plotësojnë kriteret të përfitojnë nga subvencionimi.	Edhe në vitin 2024, komisioni vlerësues nuk e kishte bërë vlerësimin sipas kriterëve të paraparë me thirrje publike.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha pasuritë e komunës janë regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale, sipas kërkesave të Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore.	Komuna kishte ndërmarr veprime dhe rekomandimin e dhënë në lidhje me pronësinë e pasurive e kishte rregulluar i cili më pastaj është korrigjuar edhe regjistri i pasurive komunale.	I zbatuar

3.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë që raportet rregullta gjashtë (6) mujore të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.	Edhe për vitin 2024 vazhdon gjendja e njëjtë lidhur me mungesën e raportimit për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë bashkëpunim dhe komunikim më të mirë ndërmjet Departamentit të Tatimit në Pronë Komunale dhe Ministrisë së Financave në azhurnimin bazës së të dhënave, në mënyrë që të eliminohen gabimet e mundshme në të dhënat për tatimin e vlerësuar, apo ndonjë gabim tjetër eventual.	Edhe për vitin 2024, në bazën e të dhënave të tatimit në pronë janë identifikuar tatimpagues pa numër personal identifikues.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinoen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Edhe në vitin 2024, kishte keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategoritë ekonomike.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerja dhe në fund të pranohet puna/shërbimi dhe të kryhet pagesa.	Nuk janë marrë masat e nevojshme	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë hartimin e projekteve ekzekutive infrastrukturore para inicimit të procedurave të prokurimit.	Nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë mekanizma adekuat në forcimin e kontrolleve në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, në mënyrë që ato të përfundohen me kohë sipas planit dinamik.	Nuk janë marrë veprimet e nevojshme. Edhe në vitin 2024 kishte vonesa në realizimin e projekteve.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme gjatë faturimit të tatimit në pronë dhe në rastet kur tatimi në pronë i ngarkohet pronave të cilat janë të lirura me ligj të bëjë shlyerjen e obligimeve të tyre.	Raste të tilla janë përsëritur edhe në vitin 2024.	Nuk ka filluar zbatimi

10.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, si dhe obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimi të faturave në mënyrë që të shmangen pagesat shtesë të interesit nga vendimet gjyqësore/përmbarimore.	Kishte vonesa të pagesës së faturave mbi 30 ditë.	Nuk ka filluar zbatimi
-----	-----------------------	---	---	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Florim Beqiri, Udhëheqës i ekipit



Mexhit Ferati, Anëtar i ekipit



Jetmira Isufi, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Specifikimi i prodhuesit në paramasën dhe parallogarinë	Autoriteti Kontraktues, konkretisht Zyra e Prokurimit në Komunën e Suharekës, kundërshton fuqishëm gjetjen e parashtruar në draft-raportin në fjalë për arsye se: Në asnjë rast Zyra e Prokurimit nuk ka kufizuar kërkesat vetëm në emër të brendit. Përkundrazi, aty ku është bërë referencë ndaj një brendi të caktuar, është shtuar edhe termi “ose të ngjashme”, në përputhje të plotë me nenin 17, paragrafi 2 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Kjo dispozitë e lejon referencën në një produkt të caktuar për atë kohë sa kjo nuk kufizon konkurrencën dhe përfshihet alternativa “ose të ngjashme”. Si rrjedhojë, AK nuk ka pranuar opinionin nga Departamenti i Monitorimit të KRPP-së, siç do të ndodhte në rast se specifikimet do të kufizoheshin vetëm në emër të brendit, pa përfshirë alternativat “ose të ngjashme”. Gjithashtu, mungesa e kërkesave për sqarime shtesë nga Operatorët Ekonomikë sipas nenit 53 të Ligjit për Prokurimin Publik, mungesa e kërkesave për rishqyrtim apo ankesa në OSHP, si dhe pjesëmarrja e një numri të konsiderueshëm të Operatorëve Ekonomikë në tenderin përkatës, dëshmon se nuk ka pasur kufizim të konkurrencës. Bazuar në të dhënat dhe argumentet e sipërpërmendura, Zyra e Prokurimit e Komunës së Suharekës konsideron se kjo gjetje nuk qëndron dhe kërkon që të hiqet nga raporti përfundimtar.	Me Rregulloren nr. 001/2022 për Prokurimin Publik parashihet të përdoret përshkrimi pasuar nga fjalët “ose të barasvlershme” në rastet kur nuk ka mënyrë tjetër precize ose të përshtatshme për përcaktimin e specifikimeve teknike e kërkesave përveç referencës. Po ashtu, Udhëzuesi nr. 001/2023 për Prokurimin Publik, parasheh se “Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, si rregull i përgjithshëm është i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdoret në raste të veçanta”. Rastet tuaj ku janë përmendur emrat e prodhuesve në paramasat dhe parallogaritë e projekteve, nuk kanë qenë raste të veçanta si dhe ka pasur mundësi të bëhet përshkrimi më i përshtatshëm dhe preciz i specifikave teknike pa përdor emrin e prodhuesit. Gjetja dhe rekomandimi mbetet i pandryshuar.

Përdorimi i gabuar i kontratës publike kornizë	Autoriteti Kontraktues, konkretisht Zyra e Prokurimit në Komunën e Suharekës, gjithashtu kundërshton fuqishëm gjetjen e parashtruar në draft-raportin në fjalë për arsye se: Kontrata në fjalë ka pas të bëjë vetëm me ri-konstruim (riparim mirëmbajtje të Rrugëve) pavarësisht nga titulli i aktivitetit të Prokurimit i cili nuk ka mundur të ndryshohet gjatë inicimit të Aktivitetit për arsye se ka qenë i aprovuar nga asambleja komunale me at titull. Me gjithat po të analizohej paramasa dhe parallogaria e këtij Aktiviteti të Prokurimit do të vërehej se kjo Kontratë ka pasur të bëjë me riparimin, mirëmbajtjen e rrugëve gjë që për këtë natyrë të punëve është lejuar përdorimi i kontratës kornizë me çmim për njësi dhe si rrjedhojë KRPP nuk ka leshur ndonjë opinion për mos përdorim të kontratës kornizë për këtë aktivitet të Prokurimit.	Komuna ka bërë vetë arsyetime pa ofruar dëshmi që e ndërron gjetjen tonë. Kontratat publike kornizë për punë sipas rregullores lejohet vetëm në rastet kur kemi të bëjë me kryerjen e punëve për riparim/mirëmbajtje. Nga pagesat e bëre me këtë kontratë ndër tjerash shihet se janë paguar për punë që kanë të bëjë me furnizimin, transport dhe ngjeshe të zhavorit, furnizim, transport dhe montim i kubëzave dhe i asfaltit, furnizim, transport dhe montim i betonit dhe armaturës që ka të bëjë me ndërtimin e mureve mbrojtëse, ndërtimi i parkingjeve nëpër shkolla, rregullimin e parkingut të tregut ditor në Suharekë. E gjetura dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.
---	---	---

Mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike për subvencionimin e fermerëve me serra në bujqësi	Lidhur me pretendimin tuaj se pesë (5) përfitues të serave nuk kishin ofruar dëshmi që tregon se kanë në posedim së paku 0.5ha tokë bujqësore, konsiderojmë se pretendimi në fjalë nuk qëndron dhe atë për arsyet si në vijim: 1. Të gjithë aplikuesit për kriterin në fjalë kanë dorëzuar si dëshmi Certifikatën e Pronës (E cila mund të nxjerrët vetëm nga pronarët apo familjarët si të autorizuar nga pronari i tokës), ku për shkaqe të rrethanave brenda familjare, pronat figurojnë të jenë në emër të prindërve, gjyshërve apo axhallarëve (paraardhësve), por që janë nën posedim apo shfrytëzim nga ana e aplikuesit apo familjes në fjalë. Andaj referuar thirrjes ne nuk kemi specifikuar që decidimisht aplikuesi të jetë edhe pronar ligjor apo pronar i drejtpërdrejtë i pronës por që të dëshmoj përmes fletës-poseduese që posedon-shfrytëzon pronën në interes të tij apo familjes, pjesë e të cilës janë edhe pronarët juridik (faktik) të tokës. 2. Me kërkesën tuaj, për të njëjtit aplikues së bashku kemi dalë në terren për tu siguruar se pronat në fjalë janë duke u shfrytëzuar nga aplikuesit-përfituesit e subvencioneve dhe se pasuria e përfituar nga subvencioni është vënë në funksion. Me që rast ju kemi siguruar se pronat ku janë të vendosura asetet e përfituara nga subvencionet janë pronat të cilat i kanë nën posedim aplikuesit apo dikush familjarët - paraardhësit e tyre. Andaj për të forcuar argumentin tonë ne po ju bashkëlidhim dokumentacionin e nevojshëm për 5 aplikuesit në të cilat përfshihen: Certifikata e Pronës (e njëjta e cila gjendet në dosjen e aplikimit) si dhe Certifikatat e Lindjes, Martesës, Vdekjes apo Bashkësisë Familjare të cilat dëshmojnë relacionin familjar që ka përfituesi i subvencionit me pronarin juridik të tokës bujqësore.	Ndër kriteret e kërkuara për aplikim ishte edhe kërkesa që fermeri duhej të posedojë tokë bujqësore së paku 0.5ha. Në thirrjen publike nuk është kërkuar që aplikuesi të dëshmoj përmes fletës-poseduese që posedon-shfrytëzon pronën në interes të tij apo familjes, ashtu siç ju theksoni në koment. Për mostrat tona ne kemi gjet se këta fermer kishin ofruar dëshmi për toka bujqësore me certifikata të pronës ku shihet se prona nuk është në emër të fermerit me ç'rast nuk janë ofruar ndonjë dëshmi/marrëveshje që ka të drejtën e shfrytëzimit së pronës. Sa i përket dëshmimeve që keni ofruar në lidhje me certifikatat e lindjes, martesës, vdekjes apo bashkësisë familjare të cilat dëshmojnë relacionin familjar që ka përfituesi i subvencionit me pronarin juridik të tokës bujqësore, ju njoftoj se ky nuk kishte qenë kriter i përzgjedhjes prandaj dokumentet nuk ishin pjesë e dosjes e së aplikantve që ne kemi testuar. Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuar.
--	---	--



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA

MUNICIPALITY OF SUHAREKA



18-04-2025

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIC OF KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
DËRGUAR - DOSTAVLJENO - SENT			
Nr. Br. No.	Data Datum Date	Selja Spisite Mg.	Adresa Adresa Adresa
177475	18-04-2025		

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
18-04-2025			
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Klasif. Rod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.
04	47	540	1+7

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar Draft Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Suharekës për vitin 2024,
- pajtohem pjesërisht/ me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; **përveq Çështjeve B4,A4,dhe A6** për të cilat kam dërguar komentet,si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve,i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Bali MUHARREMAJ, Kryetar i Komunës së Suharekës

Data: 17/04/2025, Suharekë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Për projektin “Ndërtimi i sheshit Brigada 123- vazhdim” mjetet janë marr: 50,000€, nga kodi i projektit 54161 Ndërtimi i shtigjeve të ecjes nga Budakov-Vraniq-Mushtisht deri në Grejkoc, 59,999.99€, dhe 4,730€, nga kodi i projektit 54085 Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në qytet dhe fshatrat: Samadrexhë, Bllac, Sllapuzhan, Peqan, Semetisht, Reshtan, Studenqan, Kasterc dhe 1,150.91€ nga kodi i projektit 52529 Ndërtimi dhe rregullimi i varrezave në Biraq. Për projektin “Ndërtimi dhe rregullimi i varrezave në Biraq” mjetet janë marr: 40,000€, nga kodi i projektit 54156 Ndërtimi i Impiantit për ujera të zeza në Dubravë dhe 40,000€, nga kodi i projektit 54079 Ndërtimi i rrugëve lokale në Suharekë. Për projektin “Ndërtimi dhe rregullimi i kolektorit në rrugën Skenderbeu” mjetet janë marr: 12,407.90€, nga kodi i projektit 54161 Ndërtimi i shtigjeve të ecjes nga Budakov-Vraniq-Mushtisht deri në Grejkoc, dhe 5,790€ nga kodi i projektit 54009 Ndërtimi i infrastrukturës rrugore për bujqësi dhe pylltari në fshatrat. Për projektin “Ndërtimi i nënstacionit policor dhe mini objektit për zjarrëfiksi” mjetet janë marr: 23,103.18€ dhe 11,926.96€, nga kodi i projekti 52376 Ndërtimi i rrugës Samadrexhë-Terrnje-Studenqan. Për projektin “Ndërtimi i rrugëve lokale Ramush Matoshi dhe Sadri Buzhlani në Popolan” mjetet janë marr: 2,986.07€, nga kodi i projekti 54085 Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në qytet dhe fshatrat. Për projektin “Ndërtimi dhe sanimi i rrugëve lokale Sopijë-Vraniq dhe Reqan-Bukosh” mjetet janë marr: 14,525.6€, nga kodi i projekti 54085 Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në qytet dhe fshatrat. Për projektin “Ndërtimi i tregut javor dhe hapësirave të gjelbëruara në Shirok” mjetet janë marr: 14,000€, nga kodi i projekti 54085 Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në qytet dhe fshatrat. Për projektin “Ndërtimi i aneksit të SHFMU Besim Ndrecaj- Maqitevë” mjetet janë marr: 17,000€, nga kodi i projekti 54176 Ndërtimi i sallës sportive “Vëllezërit Frashri” në Bukosh dhe 7,592.10€, nga kodi i projekti 54161 Ndërtimi i shtigjeve të ecjes nga Budakov-Vraniq-Mushtisht deri në Grejkoc.
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.